



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501297/11

Tiranë, __. __. 2015

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për furnizimin normal me ujë të pijshëm si dhe instalimi i matësve, për banorët e fshatit Lazarat, Gjirokastër.*

Drejtuar: **BASHKISË**
Kryetares, znj. Zamira RAMI,

GJIROKASTËR

E nderuar znj. Rami,

Sikurse jeni vënë në dijeni, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë znj. V. Ç., e cila ankohet, për mungesë të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe faturim aforfe.

Referuar ankesës, me shkesën tuaj nr. 3185/1 Prot., datë 25.09.2015, informoni se: ***"... Njësia administrative Lazarat ... furnizohet me ujë një herë në dy ditë nga një orë ... Për mungesë të matësve të ujit me Vendim të ish-Këshillit të Komunës faturimi i konsumit të ujit bëhet aforfe ..."***

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, duke e konsideruar të drejtë pretendimin e qytetares parashtrohet sa vijon:

Bazuar në nenin 4, shkronja "e", të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, "*Për mbrojtjen e konsumatorit*", ndër të tjera parashikohet si e drejtë bazë për konsumatorin edhe ofrimi i shërbimeve publike, e në rastin konkret furnizimin me ujë të pijshëm. Kjo e drejtë, konsumatorit nuk po i shërbehet për përmbushjen e kërkesave të tij, në drejtim të pajisjes me një rrjet të standardizuar uji.

Ofrimi i shërbimit publik të furnizimit me ujë të pijshëm, në gjykimin tonë, është një nevojë thelbësore për individët dhe për rrjedhojë një e drejtë elementare për ta poseduar atë lirisht dhe në përputhje me standardet.

Gjithashtu, në referim të nenin 40, paragrafët 1, të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, "*Për Mbrojtjen e Konsumatorit*", parashikohet: ***"... 1. Shitja e energjisë dhe e furnizimit me ujë llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet aparateve matëse ..."***

Për sa më sipër, në mbrojtje të interesave të ligjshme të konsumatorit, duke e vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në ligj këtë problematikë, kërkojmë marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me ujë të pijshëm në mënyrë të vazhdueshme, si dhe vendosjen e matësve, gjë që do të eliminojë faturimin aforfe të banorëve të këtij fshati, të cilët do të faturohen sipas konsumit real.

Në përfundim, Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e parë vazhdimin e kësaj situatë, si shkak për cenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit, në bazë të nenit 63/3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se:

“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”, si dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin normal me ujë të pijshëm si dhe instalimin e matësve të konsumit të ujit për çdo abonent, që në të ardhmen konsumatori të mos paguajë më faturimeve aforfe.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të informohemi brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ (SALIU)